



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:081750

Datë: 04.10.2022

Numri i dokumentit: 03488228

P.nr.113/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, në çështjen penale ndaj të pandehurit L.S nga Rep. e Maqedonisë së Veriut, për veprën penale, Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.509/22 të datës 29.04.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 03.10.2022, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Fatos Ajvazi dhe të pandehurit, të njëjtën datë, mori dhe shpalli, ndërsa me datë 04.10.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri L.S nga H..., rr.1 nr..., Shkup-Republika e Maqedonisë së Veriut, i lindur më dt... nga i ati A... dhe e ëma S..., e gjinisë B... shqiptar, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i martuar, ka të kryer shkollën e memse, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike , me nr .personal:

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 24.03.2022 rreth orës 20:05 ne Pikën Kufitare në Hani Elezit, i pandehuri me qëllim që të kalojë pikën kufitare nga Rep. e Maqedonisë se Veriut në Rep. e Kosovës, ka përdorur dokumentin e falsifikuar dhe atë Certifikatën e Vaksinit të Covid -19 , në atë mënyrë që pas ndaljes për kontroll nga zyrtarët kufitarë, i njejtë prezanton certifikatën në fjalë , ashtu që pas skanimit të së njëjtës kodi i kësaj certifikate nuk ka treguar të dhëna nga Ministria e Shëndetësisë, por leximi ka devijuar në një web- faqe të dyshimtë me ç’rast në sistem është shfaqur shenjë “... “ që nënkupton dokument të dyshimtë.

Me këtë veprim, i pandehuri ka kryer veprën penale, Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par. 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 2,3,38,43,69,70,71 par.1 nenpar.1.3 te KPRK-së, dhe nenit 359,360,361 dhe 365 të KPP-së, e

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 250.00 €(dyqind e pesdhjetë euro).

I pandehuri është i obliguar që dënimin me gjobë t’u paguajë brenda afatit prej 15 ditësh, por jo me gjatë se dy muaj pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë dhe atë në dy këste.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën , gjykata do t’u zëvendesoje dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur shumën prej 20 € për çdo ditë burgu.

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguajë pranë kësaj gjykate shumën prej 20.00€, ne emër te paushallit gjyqesor, derisa per Fondin per kompensimin e viktimave te krimit shumën prej 30.00€, në afat te njëjtë me gjoben, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.509/22 të datës 29.04.2022, të pandehurin L.S, e ka akuzuar për veprën penale, Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i njëjti të shpallët fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

Ne bazë të kësaj aktakuze, Gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar më datë, 03.10.2022 me të cilin rast, Prokurori i Shtetit Fatos Ajvazi deklaroi se, mbetet në tërësi pranë aktakuzës së parashtruar pranë kësaj gjykate pa ndryshime dhe plotësime.

I pandehuri në fjalën e tij në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza, ka shtuar se ndihet i penduar për veprimin e tij, dhe duke i premtuar gjykatës se veprime të tilla nuk do të përsërisë në të ardhmen, njëherit ka kërkuar nga gjykata që me rastin e marrjes së vendimit, t'i shqiptohet një vendim sa më i ulët që të jetë e mundur, meqë është hera e parë që akuzohet për vepër penale.

Prokurori i shtetit në fjalën e tij është dakorduar me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, meqë pranimi u bë vullnetarisht nga i pandehuri, dhe është në përputhje me dispozitën e nenit 248 të KPP-së dhe njëherit i ka propozuar gjykatës që të bëjë pranimin e fajësisë për të pandehurin dhe t'i shqiptojë sanksion penal sipas ligjit.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 248 të KPP-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza, se akti akuzues nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime teknike.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 të KPRK-se, kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza në shqyrtimin fillestar, shprehja e pendesës për veprimin e tij, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, bazuar në evidencën e gjykatës i njëjti nuk është përsëritës i veprave penale,

ndërsa rrethanë te posaçme rënduese, Gjykata nuk gjeti, përpos veprimeve të të pandehurit të cilat paraqesin tiparet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor.

Andaj, gjykata për këto arsye, të pandehurit L.S , për veprën penale për të cilën ngarkohet sipas aktakuzës, e gjykoi me dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është ne proporcion me veprën si dhe sjelljen e te pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do te ndikojë tek i pandehuri dhe personat tjerë që të shmangen nga kryerja e veprave penale, dhe të forcojë detyrimin për respektimin e ligjit, dhe me këtë edhe të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, i paraparë në nenin 38 te KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 450 par 2 të KPP-se.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, është marrë konfor nenit 39 par.3 nenpar.3.1 te Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEGA KAÇANIK
P.nr.113/22 datë 04.10.2022

Sekretarja Juridike,
Indira Beqa

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.